



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02/2066 Dt. 03/12 /2020

Në bazë të nenit 17-të dhe nenit 23 pika 1.3 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, Këshilli Drejtues në mbledhjen XXII, të mbajtur më 2.12.2020, miraton këtë :

**RREGULLORE PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE – SHKENCORE NË UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN**

**Neni 1**

Dispozitat e përgjithshme

Më këtë Rregullore organizohet veprimtaria kërkimore – shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Universitetit Publik " Kadri Zeka" Gjiilan (në tekstin e më poshtëm UKZ), të pjesëmarrësve të veprimtarisë kërkimore – shkencore hulumtuese dhe publikimin e rezultateve kërkimore – shkencore.

**Neni 2**

Stafi akademik i UKZ-së është i obliguar të bëjë kërkime shkencore dhe punë hulumtuese në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga dokumentet strategjike të UKZ-së. Çdo anëtar i stafit akademik, do të vlerësohet një herë në vit për kontributin e tij në veprimtarinë shkencore. Ky vlerësim do të jetë bazë për avancimet akademike në Universitet.

**Neni 3**

1. UKZ përkushtohet për krijimin e kushteve të përshtatshme për veprimtari kërkimore - shkencore dhe veprimtari hulumtuese dhe për të ndihmuar stafin akademik që të arrijë rezultate konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar edhe duke i mbështetur financiarisht.
2. Stafi akademik i cili prezantohet në çdo takim apo eveniment duhet të paraqitet me logon e UKZ-së.

**Neni 4**

4.1. Veprimtaria kërkimore – shkencore përfshin këto aktivitete:

1. Realizimin e hulumtimeve themelore, të avancuara dhe aplikative me qëllim të zhvillimit të hulumtimit shkencore në fushat studimore që janë në UKZ dhe fushave të profileve të stafit akademik në UKZ;
2. Organizimin e konferencave shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, të punëtorive dhe seminareve, hulumtimit shkencor dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera hulumtuese në vend dhe jashtë;
3. Bashkëpunimin me ndërmarrjet ekonomike dhe industrinë;

4. Përgatitjen e studimeve në fushat e filologjisë, shëndetësisë, edukimit, shkencave sociale, shkencave aplikative etj.;
5. Patentimin;
6. Përgatitjen e ekspertizës në fushat e mësipërme dhe kontrollin e cilësisë së dokumentacionit teknik;
7. Përpilimin e programeve investuese dhe programeve të tjera;
8. Organizimin e seminareve dhe zhvillimin profesional të stafit akademik në lëmenjtë shkencorë relevantë për UKZ;
9. Veprimtarinë botuese (botimin e teksteve universitare, monografive dhe revistave shkencore);
10. Veprimtarive të tjera hulumtuese – shkencore në fushat që mbulohen me programet studimore në UKZ.

#### Neni 5

- 5.1. Veprimtaria kërkimore – shkencore nga ana e instituteve realizohet në formë të kërkimeve themelore dhe kërkimeve të aplikuara që janë në lidhje të ngushtë me nevojat e interesit publik.
- 5.2. Bartësi kryesor i aktiviteteve kërkimore- shkencore është stafi akademik i UKZ-së.

#### Neni 6 Organizimi

6.1 Në përputhje me Strategjinë për veprimtari dhe kërkime shkencore në UKZ, prorektori për marrëdhënie ndërkombëtare në bashkëpunim me Zyrën për kërkime shkencore dhe menaxhimin e projekte është përgjegjës për:

1. Udhëheqjen e aktiviteteve të hulumtimit në UKZ, në pajtim me misionin dhe planin strategjik;
  2. Bashkëpunimi ndërkombëtar shkencor;
  3. Planin vjetor të UKZ-së për punë kërkimore – shkencore së bashku me buxhetin vjetor për hulumtim shkencor;
  4. Shpërndarjen e mjeteve të nevojshme për realizimin e veprimtarisë hulumtuese;
  5. Koordinimin dhe përparësinë e planit dhe aktiviteteve të propozuara hulumtuese shkencore;
  6. Informimin e organeve udhëheqëse të UKZ-së rreth aktiviteteve hulumtuese dhe përfaqësimin e këtyre aktiviteteve brenda dhe jashtë shtetit;
  7. Përpilimin e politikave, rregulloreve dhe procedurave për rregullimin e veprimtarisë hulumtuese;
  8. Konfirmimin e kërkesave për financimin e hulumtimit;
  9. Ndjekjen e pagesave rreth kompensimeve për punët e realizuara, shërbimeve të dhëna dhe furnizimit me material dhe mjete pune për koordinatorët e projekteve;
  10. Evidentimin dhe ruajtjen e kontratave me shfrytëzuesit e shërbimeve;
  11. Shpenzimet për mjetet teknike për hulumtim dhe infrastrukturë hulumtuese;
  12. Realizimin e aktiviteteve tjera lidhur me veprimtarinë hulumtuese.
- 6.2. Veprimtaria hulumtuese në UKZ mbikëqyret nga prorektori/ja për kërkime shkencore dhe Komisioni i formuar nga Senati. Kjo trupë në bashkëpunim me Këshillin Botues është përgjegjëse për:
1. Përkrahjen e zhvillimit profesional të kuadrit akademik;
  2. Mbikëqyrjen e administrimit dhe monitorimin e projekteve hulumtuese vendore dhe ndërkombëtare;
  3. Përkrahjen e aplikimeve për projekte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
  4. Mirëmbajtjen e seksioni për hulumtim shkencore të uebfaqes universitare;
  5. Koordinimin e bazës së të dhënave për hulumtim shkencore.
- 6.3. Në nivel të fakulteteve, përgjegjës për aktivitete kërkimore shkencore janë dekani dhe Këshilli i Fakultetit.
- 6.4. Hulumtuesit individual janë përgjegjës për hulumtimin personal dhe të arriturat e tyre i regjistrojnë në serverin universitar dhe platformat e tjera të njohura nga MASH dhe nga universiteti.

## Neni 7 Hulumtuesi i viti

1. Bazuar në Ligjin për arsim të lartë të Republikës së Kosovës, hulumtuesit më të mirë mund të stimulohet me një pagë të profesorit të rregullt.
2. Për këtë qëllim Komisioni për hulumtim i analizon rezultatet e hulumtimit të të gjithë stafit akademik në bazë vjetore nga databazat dhe platformat e hulumtimit dhe përgatit listë të hulumtuesve më të mirë për vlerësim të mëtutjeshëm. Nga kjo përzgjedhje Komisioni propozon hulumtuesin për shpërblim.
3. Rektori e miraton propozimin.
4. Komisioni për zgjedhjen e hulumtuesit të vitit bazohet në bazë të revistave ndërkombëtar dhe platformave ku bëhet publikimi i punimeve.
5. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare të indeksuara sipas UA të MASHT nr.01-2018 datë 19.01.2018 neni 3, paragrafi 1.1 dhe 1.2 saktësisht në: WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS, kanë indeksin e vlerësimit 1.
6. Punimet e publikuara në revistat ndërkombëtare të indeksuara sipas UA të MASHT nr.01-2018 datë 19.01.2018 neni 3, paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 saktësisht në EBSCO, WORLD CAT dhe DOAJ, kanë indeksin e vlerësimit 0.5.

## Neni 8 Dispozitat financiare

1. Veprimtaria kërkimore – shkencore financohet nga buxheti i UKZ-së, MASH dhe partnerët dhe donatorët të jashtëm bashkëpjesëmarrës në projekte.
2. UKZ stimulon pjesëmarrjen e stafit akademik dhe administrativ në shkrimin e projekteve të brendshme dhe ndërkombëtare të cilat futen në konkurrencën e ngushtë, në vlerën e përqindjes së projektit si më poshtë.
3. Për vlerën e projektit në shumën 29.999 euro, vlera e përqindjes së projektit është 5%.
4. Për vlerën e projektit në shumë 59.999 euro, vlera e përqindjes së projektit është 4%.
5. Për vlerën e projektit në shumë 99.999 euro, vlera e përqindjes së projektit është 3%.
6. Për vlerën e projektit në shumë mbi 100.000 euro, vlera e përqindjes së projektit është 2%.
7. Nëse projekti ka koautor, shuma e fituar ndahet në pjesë të barabarta.
8. Me buxhetin për kërkime dhe hulumtime shkencore mbulohen:
  - 8.1. Projektet hulumtuese të fakulteteve;
  - 8.2. Pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare;
  - 8.3. Botimi i punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare;
  - 8.4. Shpenzimet për bashkëfinancim- pjesëmarrje në projekte hulumtuese rajonale dhe ndërkombëtare.
9. Lartësia e mjeteve financiare për veprimtari kërkimore shkencore caktohet me buxhetin UKZ-së, të miratuar nga Këshilli Drejtues.

## Neni 9

Me buxhetin për veprimtari kërkimore shkencore mbulohen shpenzimet për botimin e teksteve universitare dhe monografive nga stafi akademik me orar të plotë, në pajtim me programin e lëndës dhe tekste të tjera që konsiderohen për UKZ-në.

## Neni 10

1. Botimi në revista shkencore ndërkombëtare financohet nga UKZ në këtë mënyrë:

2. Botimi në revistat ndërkombëtare të indeksuara sipas UA të MASHT nr.01-2018, datë 19.01.2018, neni 3, paragrafi 1.1 dhe 1.2, saktësisht në WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS stimulohen me 1000.00 euro.
3. Botimi në revistat dhe platformat e indeksuara sipas UA të MASHT nr.01-2018 datë 19.01.2018 neni 3 paragrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5, saktësisht në EBSCO stimulohet me 500 euro.
4. Nëse një punim ka dy e më shumë autorë të UKZ-së, autori i parë merr 50 % të shumës ndërsa 50 % e shumës tjetër ndahet nga autorët e tjerë të UKZ-së.

#### Neni 11

Zbatimi i kësaj rregulloreje bëhet në përputhje me procedurat e parapara në statutin e UKZ-së.

#### Neni 12 Dispozitat kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregulloja për Mbështetje të mobilitetit dhe aktiviteteve të tjera të stafit akademik në UKZ Nr. 01/719, datë 07.07.2015.

#### Neni 13

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UKZ-së.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Ibrahim Kosumi".

MSc. Ibrahim Kosumi  
Kryesues i Këshillit Drejtues